REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE SHËNDETESORE DHE STREHIMIT**
**SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE DHE PAGESAVE**

**PROJEKT – VENDIM**

**Nr** 4 **.Datë** 22.01 **2026.**

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKNOMIKE PËR FAMILJET APLIKUESE, TË CILAT NUK JANË SHPALLUR PËRFITUESE NGA SISITEMI I PIKËZIMIT DHE QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDET E BUXHETIT VENDOR PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2026.**

Bazuar në Nenin 8 pika 2, 9/1 pika 1/1 neni 24 neni 54, 55 të Ligjit Nr. 139/2015 date 17.12.2015 "Per Veteqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligjin Nr. 121/2016 "Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë" Ligjit Nr. 57/2019 "Për asistencën Sociale në Repblikën e Shqipërisë" i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 597 datë 04.09.2019 " Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe të përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" i ndryshuar, VKM Nr. 956 datë 07.12.2016 " Për përcaktimin e kritereve dhe të detajeve të formulës se unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike",VKM Nr.855 datë 26.12.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr.597, datë 04.09.2019,të këshillit të ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike " të ndryshuar, Udhëzimit Nr. 3 datë 17.02.2017 "Mbi zbatimin e vendimit Nr. 955 datë 07.12.2016 të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike"(i ndryshuar), Udhëzimit Nr. 4 datë 17.02.2017 "Për përllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike " I ndryshuar, Udhëzimit Nr. 5 datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok –ndihmën ekonomike deri ne 6%" I ndryshuar, VKB Nr. 9 datë 21.01.2025 " Për miratimin e kritereve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi I pikëzimit dhe që do të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi I kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6%",VKB nr. 8 datë 21.01.2025 "Për miratimin e kritereve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi I pikëzimit dhe që do të trajtohen me ndihmën ekonomike nga fondet e buxhetit vendor.

*Adresa: Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9; Tel+35581122288; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com; web: http://bashkiadevoll.gov.al/*

## PROPOZOJ:

Kriteret e familjeve në nevojë që do të trajtohen me Ndihmë Ekonomike nga fondi i buxhetit vendor:

1. Familjet të cilat kanë aplikuar në sistemin elektronik të Ndihmës Ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi online i pikëzimit për arsye të ndryshme.

2. Familja para se të përzgjidhet për tu trajtuar nga ky fond, duhet të jetë verifikuar paraprakisht duke ju bërë vlerësimi i gjëndjes social-ekonomike nga një komision i ngritur nga Administratorët Shoqërorë dhe Përgjegjësi i pagesave.

3. Familjet duhet të jenë familje në nevojë, në kushte të vështira social-ekonomike,pa të ardhura ose me të ardhura të pakta.

4. Familjet me k/familjarë të ve apo të divorcuar me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë ose të lartë.

5. Familjet me të moshuar përfitues të një pensioni pleqërie që kanë probleme shëndetësore dhe të ardhura të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet bazë.

6. Familjet me beqarë/beqare të vetmuar që jetojnë në kushte të veshtira ekonomike me të ardhura të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet bazë.

7. Familjet me anëtarë të cilët kanë probleme shëndetësore por që nuk trajtohen me pagesë PAAK.

8. Familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme që kanë në përbërje të tyre fëmijë që ndjekën arsimin e mesëm dhe të lartë.

9. Fëmijët të cilët ndjekën arsimin e mesëm ose të lartë dhe janë të vetëm në certificate për shkak të problemeve sociale familjare apo raste fatkeqësie kur të dy prindërit kanë ndëruar jetë.

10. Familjet në varfëri ekstreme dhe raste fatkeqësie që nuk i përballojnë dot shpenzimet, në bazë të të ardhurave të deklaruara dhe që janë përfituese nga sistemi elektronik.

11. Familjet të cilat kanë fëmijë në moshë madhore me probleme të ndyshme sociale (përdorues të lëndëvë narkotike, probleme me ligjin, etj.) të cilët kanë vështirësi punësimi.

12. Familjet rome të cilat kanë problem me transferimin, regjistrimin apo vështirësi punësimi,etj.

13. Familjet të cilat kanë në përbërje të tyre dy anëtarë në çertifikatë të cilët kanë kaluar moshën aktive për punë dhe nuk kanë plotësuar moshën e pensionit për tu trajtuar me pagesë.

14. Familjet në nevojë që kanë në përbërje të tyre persona me aftësi të kufizuar apo invalidë pune.

15. Çdo kategori tjetër familje në nevojë e cila nuk mund të plotësojë nevojat bazë jetike.

Ngarkohet për zbatim, Sektori Ndihmës Ekonomike dhe Pagesave në Bashkinë Devoll I cili ka hartuar projekt- vendimin.

1. Mbas miratimit në Keshillin Bashkiak, hyrja në fuqi do të bëhet , sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për "Vetëqeverisjen Vendore".

**Konceptoi: B.Lata**

**Konfirmoi : Z.Sinani**

**Konfirmoi bazën ligjore:E.Avdo**

**Konfirmoi:A.Rushitaj**

**Kryetar I Bashkisë**
**Eduard Duro**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA DEVOLL